

VENDIM
Nr. 579, datë 2.12.2022

PËR LICENCIMIN PËR HERË TË PARË TË SHOQËRISË RAJONALE
UJËSJELLËS-KANALIZIME LEZHË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 2.12.2022 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit 'Për licencimin për herë të parë të shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lezhë sh.a.'",

KONSTATON SE:

1. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lezhë, me shkresën nr. 68 prot., datë 7.11.2022, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të Shoqërisë Rajonale UK Lezhë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 302, datë 11.5.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura" (VKM nr. 302).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lezhë sh.a. (NUIS M28314503C) është themeluar më datë 9.9.2022, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë 51%, Bashkia Mirditë 5.88 %, Bashkia Lezhë 30.71%, Bashkia Kurbin 12.4 %;

b) shoqëria rajonale UK Lezhë aplikon për licencim për herë të parë si shoqëri e re, për shërbimin e furnizimit me ujë, largimit të ujërave të ndotura dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

c) drejtues ligjor i shoqërisë rajonale është z. Zef Maçi i diplomuar në Universitetin Politeknik Tiranës, Fakulteti Inxhinieri Mekanike në vitin 1982;

d) drejtues teknik i shoqërisë është z. Petrit Bardhi i diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, në vitin 1994 dhe ka mbi 5 vjet përvojë në profesion, sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 958;

e) drejtues teknik i shoqërisë për impiantin është znj. Suela Lekgjonaj (Simoni) i diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Hidroteknikë në vitin 2016 dhe ka mbi 5 vite përvojë në profesion, sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 958;

f) shoqëria rajonale UK Lezhë deklaron se ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 117 000 banorë të bashkive Lezhë, Kurbin dhe Mirditë;

g) shoqëria rajonale UK Lezhë sh.a. ofron shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura për 50 000 banorë të Bashkisë Lezhë.

4. ERRU-ja në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Rajonale UK Lezhë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë rajonale UK Lezhë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lezhë sh.a., me (NUIS M28314503C), në kategoritë:

a) kategoria A: “Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik”;

b) kategoria C: “Për largimin e ujërave të ndotura”;

c) kategoria D: “Për trajtimin e ujërave të ndotura”.

2. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lezhë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara, me:

a) drejtues ligjor: Zef Maçi;

b) drejtues teknik: Petrit Bardhi;

c) drejtues teknik: Suela Lekgjonaj.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lezhë sh.a. është Bashkia Lezhë, Mirditë dhe Kurbin.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Vendimi i KKRR-së nr. 447, datë 23.11.2021, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Lezhë sh.a.”, shfuqizohet;

6. Vendimi i KKRR-së nr. 379, datë 31.8.2022, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kurbin sh.a.”, shfuqizohet;

7. Vendimi i KKRR-së nr. 109, datë 18.9.2020, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Mirditë sh.a.”, i ndryshuar, shfuqizohet;

8. Drejtuesi ligjor i shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lezhë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

9. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Lezhë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

